



06/06/2022

Bulqizë Tentuan të vidhnin në një subjekt minerar, falë reagimit të menjëhershëm të Policisë arrestohet në flagrancë autori i dyshuar dhe shpallet në kërkim një shtetas tjetër

Në vijim të punës për parandalimin e vjedhjes së pronës, zbardhjen e atyre të ndodhura më parë dhe kapjen e vënien para përgjegjësisë ligjore të autorëve të tyre, specialistët për Hetimin e Krimit të Komisarariatit të Policisë Bulqizë arrestuan në flagrancë shtetasin B. B., 33 vjeç, si dhe kanë shpallur në kërkim shtetasin I. V., 28 vjeç, të dy banues në Bulqizë, pasi, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, kanë tentuar të vjedhin disa mjete pune në pronësi të një subjekti minerar, në zonën e Martaneshit.

Gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e shtetasit B. B., janë gjetur dhe sekuestruar në cilësinë e provës materiale, dy kapsolla detonatore dhe disa vegla pune, të dyshuara të vjedhura më parë nga ky shtetas.

Vijon puna për lokalizimin dhe kapjen e shtetasit tjetër të shpallur në kërkim.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Dibër, për veprat penale “Vjedhja”, mbetur në tentativë, kryer në bashkëpunim, “Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyesë dhe i municionit” dhe “Shkatërrimi i pronës”.

Share

Share

Share

Share

Email

Kërko

Enter a word for search

Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play

Download on the
App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

>

[Arkiva](#)

>

[Akademia e Sigurisë](#)

>

[Ministria e Brendshme](#)

>

[Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)

>

[Interpol](#)

>

[Europol](#)

>

[Misioni PAMECA V](#)

>

[SCPA](#)

>

[Projekti Trivalent](#)